



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 30.4.2021

Dokument prlmentar

Komision përgjegjës

R A P O R T

PËR AKTIN NORMATIV NR.18, DATË 14.4.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.137/2020, “PËR BUXHETIN E VITIT 2021”, TË NDRYSHUAR

I. Hyrje.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 30 prill 2021, shqyrtoi aktin normativ nr.18, datë 14.4.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar. Akti normativ u shqyrtua sipas rregullave të parashikuara në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relator, për këtë akt normativ, z. Anastas Angjeli.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të ftuar, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

- Znj. Adela Xhemali, Zëvendësministre;
- Znj. Mimoza Dhëmbi, Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit;
- Z. Saimir Muçmataj, Drejtor i Drejtorisë Rregullatore dhe Përputhshmërisë.

II. Baza ligjore.

Akti normativ nr.18, datë 14.4.2021 “Për disa ndryshime në ligjin nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, është paraqitur për miratim nga Këshilli i Ministrave dhe shqyrtohet nga Kuvendi mbështetur në bazën kushtetuese e ligjore, si më poshtë:

- nenet 101 dhe 160 të Kushtetutës;
- nenin 46 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- rregullat e përcaktuara në kreun III të pjesës së dytë të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e aktit normativ.

III.1. Zhvillimet ekonomike gjatë periudhës janar-mars 2021.

Rezultatet e 3-mujorit të parë evidentojnë rritjen e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit dhe rritjen e ndjeshme të investimeve publike në krahasim me planin. Treguesit kryesorë fiskalë janë realizuar si më poshtë:

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit u tejkaluuan me rreth 1.6 miliardë lekë ose 1.5 pikë përqindje në krahasim me planin. Në krahasim me të njejtën periudhë të vitit të mëparshëm, këto të ardhura rezultojnë rreth 4.4 miliardë lekë ose 4.3 pikë përqindje më të larta.

Peshën kryesore në tejkalimin e të ardhurave e kanë të ardhurat nga fondet speciale (sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe të ardhurat nga kompensimi në vlerë i pronarëve), të cilat u tejkaluuan me rreth 1.9 miliardë lekë ose 8 pikë përqindje në krahasim me planin. Brenda këtyre të ardhurave, me tejkalim të ndjeshëm janë të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore.

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat u realizuan në masën 99.9 për qind në krahasim me planin. Këto të ardhura u tejkaluuan në të gjitha zërat, përveç të ardhurave nga TVSH. Në të ardhurat nga TVSH ndikuan negativisht situata e pandemisë Covid-19, e cila solli uljen e vlerës së importit të tyre për disa kategori artikujsh, si dhe rënia e sasisë së importuar të energjisë elektrike.

Të ardhurat nga pushteti vendor rezultojnë me tejkalim të planit për 0.3 miliardë lekë ose 6.1 pikë përqindje.

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit u realizuan në masën 96 për qind. Këto shpenzime u karakterizuan nga rritja e ndjeshme e investimeve publike, të cilat rezultojnë me tejkalim të planit me rreth 4.3 miliardë lekë ose 62.4 pikë përqindje. Mosrealizimi i planit të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit ka ardhur tërësisht për shkak të mosrealizimit të shpenzimeve korrente.

Deficiti buxhetor rezultoi me një ulje prej 6.3 miliardë lekësh në krahasim me planin, si rezultat i tejkalimit të të ardhurave dhe mosrealizimit të shpenzimeve.

III.2. Ndryshimet e mëparshme në ligjin për buxhetin e vitit 2021.

Akti normativ nr.18, datë 14.4.2021 parashikon ndryshimin për herë të tretë të buxhetit të vitit 2021.

Ndryshimet e mëparshme në buxhetin e vitit 2021 janë paraqitur nga Këshilli i Ministrave me:

- Aktin normativ nr.4, datë 5.2.2021, i cili ruajti të pandryshuar deficitin buxhetor dhe borxhin publik, duke rritur përkatësisht në të njejtën vlerë (3.42 miliardë lekë) të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme të buxhetit. Qëllimi i këtij akti normativ ishte

financimi i nevojave shtesë të procesit zgjedhor. Ky akt normativ nuk ndryshoi treguesit kryesorë makroekonomikë, të parashikuar në fillim të vitit 2021, si deficitin buxhetor dhe borxhin publik.

- Aktin normativ nr.8, datë 22.3.2021, i cili mundësoi një rialokim prej 1 miliardë lekësh brenda zërave të fondit rezervë të Këshillit të Ministrave. Qëllimi i këtij akti normativ ishte sigurimi i fondit të nevojshëm për blerjen e vaksinës kundër Covid-19. Akti normativ nuk ndryshoi treguesit kryesorë makroekonomikë e fiskalë, të parashikuar në ligjin për buxhetin e vitit 2021: deficitin buxhetor, borxhin publik, të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme të buxhetit.

III.3. Parashikimet e aktit normativ nr.18, datë 14.4.2021.

Akti normativ nr.18, datë 14.4.2021 ka qëllim sigurimin e fondit të nevojshëm për blerjen e vaksinave gjatë vitit 2021 dhe për kryerjen e shpenzimeve të tjera eventuale të nevojshme kundër pandemisë Covid-19.

Për të realizuar këtë qëllim, akti normativ parashikon ndryshimet e mëposhtme në buxhetin e vitit 2021:

- Shtohen me 2 miliardë lekë shpenzimet në fondin rezervë të Këshillit të Ministrave;
- Shtohen me 2 miliardë lekë të ardhurat tatimore, për të përballuar shtesën e shpenzimeve buxhetore. Kjo shtesë parashikohet në zërat si më poshtë:

Shtesa e të ardhurave për vitin 2021 (në milionë lekë)

Nr.	Të ardhurat	Shtesa e buxhetit 2021
1	Kontributet (fondet speciale)	800
2	Tatimi mbi fitimin	600
3	Akciza	400
4	Tatimi mbi te ardhurat personale	200
	Totali	2000

Shtesa e të ardhurave tatimore bazohet në analizën e kryer nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për ecurinë e tyre gjatë periudhës janar-mars, si dhe pritshmëritë për realizimin e tyre deri në fund të vitit aktual.

Akti normativ nuk ndryshon treguesit kryesorë makroekonomikë e fiskalë, të parashikuar në ligjin për buxhetin e vitit 2021: deficitin buxhetor dhe borxhin publik. Deficiti buxhetor mbetet 6.5 për qind e PBB, ndërsa borxhi publik 78.6 për qind e PBB. Këta tregues janë parashikuar kundrejt rritjes ekonomike prej 5.5 për qind.

III.4. Nevoja për aktin normativ.

Akti normativ nr.18, datë 14.4.2021 mbështetet në prioritetet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Vaksinit në vendin tonë për të arritur imunizimin e të gjithë popullsisë kundër pandemisë Covid-19. Kjo Strategji ka objektiv vaksinimin e 2.2 milionë personave, për të cilët nevojiten 4.4 milionë doza vaksinash.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale evidentoi se deri në periudhën e hartimit të aktit normativ, janë nënshkruar kontrata për sigurimin e 2.2 milionë dozave të vaksinave. Për të realizuar objektivin strategjik, nevojiten edhe 2.2 milionë doza të tjera vaksinash. Për këtë arsye, kjo ministri, në datën 12 prill 2021, paraqiti kërkesën për shtesën e buxhetit të vitit 2021 me 2 miliardë lekë.

Kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u mbështet nga Këshilli i Ministrave, i cili bazuar në nenin 101 të Kushtetutës, e miratoi atë me akt normativ dhe ia paraqiti Kuvendit për shqyrtim.

III.5. Paraqitja e ndryshimit buxhetor me akt normativ.

Ndryshimi i buxhetit përmes aktit normativ është një praktikë e ndjekur prej vitesh, kur plotësohen kërkesat e nenit 101 të Kushtetutës, si dhe të vendimeve nr.24, datë 10.12.2006 dhe nr.23, datë 16.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

Në rastin konkret, ndryshimi buxhetor është i nevojshëm dhe emergjent, për të vijuar procesin e vaksinimit të popullsisë në vendin tonë, duke ndihmuar në parandalimin e përhapjes së pandemisë Covid-19.

Ndryshimi buxhetor plotëson edhe kriterin kushtetues të përkohshmërisë, pasi akti normativ vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë maksimale prej 45 ditësh. Pas këtij afati, akti normativ duhet të miratohet nga Kuvendi, që të marrë fuqinë e ligjit.

III.6. Bazueshmëria e ndryshimit buxhetor në ligjin organik të buxhetit.

Ndryshimi buxhetor përmes aktit normativ është në përputhje me ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar. Sipas këtij ligji, fondi rezervë krijohet për të financuar shpenzime jo të përhershme dhe të paparashikuara

në fazën e përgatitjes së buxhetit. Fondi rezervë përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Miratimi i përdorimit të tij bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Gjithashtu, ligji nr.9936, datë 26.6.2008 parashikon se, në rast se kërkesa për fonde shtesë nuk mund të plotësohet përmes rishpërndarjes së fondeve buxhetore, Ministri i Financave mund t'i propozojë Këshillit të Ministrave plotësimin e saj, nëpërmjet përdorimit të fondit rezervë të buxhetit të shtetit.

Përgatitja e vaksinës kundër Covid-19, në botë, është zhvilluar me ritme shumë të shpejta, ndaj edhe parashikimi i fondeve buxhetore për vaksinimin ka paraqitur vështirësi.

Pas kërkesës së paraqitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për shtesën e fondeve buxhetore për procesin e vaksinimit të popullsisë, duke u mbështetur në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008, Këshilli i Ministrave parashikoi mundësinë e financimit të fondeve shtesë për blerjen e vaksinës përmes fondit rezervë të buxhetit të shtetit.

IV. Efektet financiare.

Akti normativ nuk prek parametrat kryesorë makroekonomikë e fiskalë, siç janë deficitit buxhetor dhe borxhi publik. Këta tregues mbeten në nivelet e parashikuara në fillim të vitit.

V. Diskutimi në Komision.

Znj. Mimoza Dhëmbi, Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, paraqiti ndryshimet buxhetore të parashikuara në aktin normativ. Ajo theksoi se viti 2021 është një vit i veçantë, për shkak të dy faktorëve kryesorë: zgjedhjeve të përgjithshme, për të cilat u miratuan shpenzime shtesë, mbi ato të planifikuara në fillim të vitit, si dhe pandemia shëndetësore, e cila paraqet vështirësi në planifikim. Për këto arsye, ndryshimet buxhetore, megjithëse janë të shpeshta (3 ndryshime brenda 4 muajve të parë të vitit), janë të domosdoshme. Me financimin e parashikuar në aktin normativ përmbillet financimi total i shpenzimeve të vaksinimit për të gjithë qytetarët e vendit.

Z. Anastas Angjeli, në cilësinë e relatorit, theksoi se akti normativ për buxhetin shqyrtohet në Komision në vijim të akteve normative lidhur me dy marrëveshje për sigurimin e vaksinës “Sputnik V” kundër Covid-19. Të gjitha këto akte janë dëshmi e përpjekjeve të Qeverisë për të siguruar financimin e plotë të vaksinimit të popullsisë. Sigurimi i vaksinave është një aksion i madh humanitar dhe shëndetësor për qytetarët.

Ndryshimet buxhetore për financimin e vaksinave, edhe pse nuk janë të zakonshme, për shkak të shpeshtësisë së tyre, janë të domosdoshme. Në të gjithë botën vendet e zhvilluara europiane ende nuk kanë siguruar vaksinat për të gjithë popullsinë e tyre, ndërsa Shqipëria është ndër

vendet me rezultate shumë të mira në këtë proces, duke synuar përfundimin e vaksinimit të të gjithë popullsisë deri në fillim të vitit 2022.

Më tej, relatori paraqiti disa informacione, të përgatitura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, lidhur me procesin e vaksinimit, se deri tani në vendin tonë:

- janë kontraktuar 2 189 590 doza vaksinash;
- kanë mbërritur 711 740 doza vaksinash;
- kanë qenë donacion 61 170 doza vaksinash;
- janë vaksinuar me dozën e parë 399 mijë qytetarë;
- janë vaksinuar me dozën e dytë 34 400 qytetarë.

Ndryshimet buxhetore janë në përputhje me kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, si dhe me prioritetet strategjike të vendit. Këto ndryshime janë të domosdoshme dhe duhet të miratohen nga Kuvendi.

Në fund të fjalës së tij, relatori paraqiti disa rekomandime për strukturat ekzekutive, si më poshtë:

- ***Së pari***, rritja e efikasitetit në mbledhjen e të ardhurave mbetet një detyrë e përhershme e administratave tatimore e doganore, për të arritur rezultate pozitive në treguesit fiskalë dhe për të rritur qëndrueshmërinë e buxhetit. Reforma e fiskalizimit, si dhe lufta kundër efazionit fiskal dhe informalitetit duhet të vijojnë me përparësi edhe në të ardhmen.
- ***Së dyti***, përmirësimi i menaxhimit të shpenzimeve buxhetore dhe realizimi i objektivave të parashikuara në investimet publike duhet të jenë në fokus të të gjitha institucioneve buxhetore, për të kontribuar në qëndrueshmërinë fiskale dhe rritjen ekonomike të vendit. Prioritet në fushën e investimeve publike mbetet rindërtimi i vendit pas tërmetit të datës 26 nëntor 2019.

VI. Përfundim.

Mbështetur në këto argumente, Komisioni e miratoi aktin normativ nr.18, datë 14.4.2021, të Këshillit të Ministrave, me shumicë votash.

KRYETARI

Anastas ANGJELI